



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME
Zyra e Kryetarit/Sektori për Financa



Nr. 02/3/31

Datë: 31.05.2019

Bazuar në Vendimin e Kuvendit të Komunës së Shtimes, Nr.01-60/01-13263/19, datë 21.05.2019, Npi-01/147, datë 31.05.2019 për të nxjerrë në diskutim publik Draft Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunal 2020-2022 për Komunën e Shtimes, Nenin 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Zyra e Kryetarit/Sektori i Financave shpallë këtë:

NJOFTIM PËR DEBAT PUBLIK ME QYTETARË

Njoftojmë qytetarët e komunës së Shtimes, se Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur me datë 31.5.2019, ka marrë vendim që të nxjerrë në Diskutim Publik **Draft** Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunal 2020-2022 për Komunën e Shtimes.

Duke u bazuar në këtë vendim të Kuvendit, Zyra e Kryetarit, në bashkëpunim me Zyrën për Informim, organizojnë **Diskutimin Publik** (debat me qytetarë) sipas orarit në vazhdim:

Më datën **7. 6. 2019** (ditë e Premte), në ora **10:00**, Salla e kuvendit Komunal;

Më datën **13. 6. 2019** (ditë e Enjte), në ora **16:00** në SHFMU "Bajram Curri" në Petrovë, për fshatrat Petrovë, Mollopolc, përfaqësues të lagjeve.

Më datën **14. 6. 2019** (ditë e Premte), në ora **10:00** në Shkollë Filllore "Lasgush Porodeci" Muzeqinë për fshatrat: Muzeqinë, Vojnovc, Gjurkoc, Gllavicë dhe Rashincë.

Më datën **14. 6. 2019** (ditë e Premte), në ora **15:00** në Sallën e Kuvendit të Komunës së Shtimes **Debatet me Qytetarë dhe subjekte tjera.**

Debatet me Qytetarë dhe subjekte tjera do të mbahen në ndërtesën e Komunës së Shtimes, në sallën e Kuvendit, Nr. 01 (kati përdhes).

Ftojme qytetarët e Komunës së Shtimes, përfshirë edhe anëtarët e Kuvendit të Komunës, shoqërinë civile dhe të tjerët që të kontribuojnë me pjesëmarrjen e tyre në këtë debat.

Draft Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunal 2020 - 2022 për Komunën e Shtimes mund ta shkarkoni nga uebfaqja zyrtare e komunës: kk.rks-gov.net/shtime ose mund ta merrni si kopje fizike në Zyrën për Financa nr.23.

Kryetari i Komunës

